



Gati për të filluar shkollën fillore?

Tani që fëmija juaj mbush 5 vjeç, është koha të mendoni për regjistrimin e tij/saj në shkollën fillore.

Viti i parë i shkollës fillore quhet Parashkollor (Përgatitor) (Prep). Fëmijët mund të fillojnë Parashkollorin (Përgatitorin) (Prep) nëse mbushin 5 vjeç deri më 30 prill të vitit kur fillojnë shkollën.

Shkollimi është i detyrueshëm për fëmijët që janë 6 vjeç.

Si të regjistroheni në një shkollë fillore shtetërore në Viktoria

Para se të aplikoni

- Përcaktoni se në cilin vit mund të fillojë shkollën fëmija juaj, bazuar në moshën e tij/saj
- Gjeni shkollat dhe zonën tuaj shkollore në **findmyschool.vic.gov.au**
- Kontaktoni shkollat fillore nga termi i parë për të rezervuar një vizitë në shkollë (opsionale).

Si të aplikoni

- Aplikimet për Parashkollor (Përgatitor) (Prep) janë të hapura që nga fillimi i Semestrit 2
- Dorëzoni formularin e aplikimit deri të premten e fundit të korrikut
- Shkolla do t'ju kontaktojë me rezultatin brenda 2 javëve të para të gushtit.



Mësoni më shumë në
vic.gov.au/enrolling-foundation-prep